

[Shpalljet ▼](#)[I< Kthehu](#)

#01032

INSTITUTI I STATISTIKAVE**Instituti i Statistikave (INSTAT), kërkon të punësojë
punonjës me kontratë pune në pozicionet:
EKSPERT FINANCIAR DHE ADMINISTRATIV****TITULLI I SHPALLJES "EKSPERT FINANCIAR DHE ADMINISTRATIV" NE
KUADER TË CENSIT TE POPULLSISË DHE BANESAVE****Termet e referencës:**

Eksperti financiar dhe administrativ do të jetë përgjegjës për:

- a) proceset financiare, administrative të zbatimit të aktiviteteve të Censit të cilat mbulohen nga Projekti;
- b) përgatitjen e raporteve financiare të kontratës së Grantit dhe paraqitjen e tyre pranë Njesisë IPA pas konfirmimit të njësisë/ekipit përgjegjës për financën;
- c) Përgatitjen e pasqyrave financiare në zbatim të kontratës së Grantit;
- d) përgatitjen e raportve periodike mujore/tremujore të menaxhimit të riskut të Projektit dhe ia raporton pranë Njesisë IPA;
- e) përgatitjen e draft shkresave për pagesa në lidhje me zbatimin e kontratës së Grantit dhe pagesën e punonjësve të kontraktuar nëpërmjet fondeve të Grantit;
- f) organizimin e takimeve të Komitetit të Lartë Drejtues për Projektin, si dhe mbajtjen e minutave të takimeve të organizuara në kuadër të Projektit;
- g) përgatitjen e materialeve për takimet periodike dhe ad-hoc në kuadër të Projektit të Censit;
- h) Bashkëpunon me grupin e punës së Censit për të siguruar zbatimin e aktiviteteve të projektit;
- i) Është përgjegjës për të raportuar pranë auditit për shpenzimet e kryera gjatë gjithë jetës së projektit;
- j) Kryen detyra dhe përgjegjësi të tjera që i ngarkohen nga Njesisë IPA dhe Njësia e Koordinimit të Cens;
- k) Kryen çdo detyrë tjetër ngarkuar nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it.

Kriteret e përzgjedhjes:

- Të zotërojë master në shkenca Ekonomike;
- Të ketë eksperiencë profesionale të paktën prej 5 vitesh si financier;
- Preferohet me eksperiencë si ekspert financiar në organizata ndërkombëtare;
- Preferohet me eksperiencë si financier në institucione publike;
- Të ketë njohuri të paketës Office, programit Alfa dhe Financa 5
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

Informacione te tjera:

Aftësi të tjera:

- Të jetë bashkëpunues;
- Të jetë i aftë të punojë në grup;
- Të jetë i aftë të kërkojë dhe të japë llogari;
- Të jetë i aftë të marrë vendime dhe të menaxhojë situata të paparashikuara;
- Të ketë aftësi të ndërtojë marrëdhënie efektive të punës me stafin e projektit dhe partnerët;
- Të jetë në gjendje të drejtojë dhe të forcojë tek bashkëpunëtorët kulturën e performacës kreative;
- Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe prezantuese.

Fusha e Njohurive

- Ligji Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare";
- Ligji Nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Marrëveshja financiare IPA II: <https://punetegashtme.gov.al/wp-content/uploads/2018/10/marrveshje-kuadr-2014-2020.pdf>

Kontraktimi do të jetë për një periudhë 27.5 muaj.

Përzgjedhja e kandidatave do të nënshtrohet një procesi testimi / intervistimi

Afati i aplikimit: 2/28/2022

Aplikimi realizohet nëpërmjet faqes së Institutit të Statistikave në seksionin e vendeve vakante për pozicionet me kontrata të përkohëshme.

Copyright © 2022 Instituti i Statistikave